

Konferenca Diaspora Flet

Konferenca katër ditore për diasporën
Lidhja dhe angazhimi i diasporës me atdheun

17 – 20 maj 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës



Organizuar nga Germin, organizatë jo-qeveritare me fokus teknologjinë dhe krijimin e mekanizmave virtuale për të lidhur dhe angazhuar diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendlindjes së tyre.

Rreth Konferencës “Diaspora flet”

Lidhja dhe angazhimi i diasporës me atdheun.



Germin organizon konferencën e parë ndërkombëtare “**Diaspora flet**”, e cila si mision ka krijimin e mekanizmave efektiv dhe mundësive për angazhimin e diasporës dhe lehtësimin e dialogut të dyanshëm me institucionet publike në vendin e tyre të origjinës.

Konferenca “**Diaspora flet**” do të shërbejë si një hapësirë për anëtarët e diasporës që të lidhen dhe të angazhohen drejtpërdrejt me institucionet publike, të bashkëpunojnë dhe avokojnë për të drejtat e tyre ekonomike, shoqërore dhe politike. Programi do të përfshijë folës, pjesëmarrës dhe politikëbërës nga Kosova, rajoni dhe komunitetet e Diasporës nga Amerika Veriore dhe Evropa, dhe disa nga ekspertët liderë botëror në fushën e angazhimit të diasporës. Së bashku ata do të trajtojnë praktikat globale dhe ndërlidhjen në mes diasporës, zhvillimit dhe diplomacisë.

Konferenca “**Diaspora flet**” do të jetë një ngjarje katër ditore e larmishme që do sjell së bashku ligjvënës, zyrtarë qeveritar dhe një grup të gjërë pjesëmarrësish - profesionistë nga diaspora, udhëheqës të komuniteteve, përfaqësues të bizneseve dhe grupeve të tjera të interesit - për të trajtuar avancimin e rolit të diasporës në zhvillimet ekonomike, shoqërore dhe politike në vendin e tyre të origjinës.

Pse Diaspora?

Historikisht e rëndësishme. Ekonomikisht e fuqishme. Kapital i pashfrytëzuar



Diaspora historikisht ka luajtur rol kyç në zhvillimet ekonomike dhe politike si në Kosovë, po ashtu edhe në rajon. Përgjatë krizave në vitet e '80-ta dhe '90-ta, diaspora ishte e përfshirë thellësisht në ngjarjet që kishin të bëjnë me Kosovën, duke ndikuar në lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre situatave mjaft të vështira. Diaspora ka qenë dhe vazhdon të jetë një kontribuese e madhe në ekonominë e vendit, kryesisht përmes remitancave, turizmit në atdhe dhe në një masë më të vogël, përmes investimeve. Megjithatë, përtej remitancave, institucionet e Kosovës, nuk kanë qenë në gjendje të përfshijnë në mënyrë adekuate diasporën në proceset politikëbërëse, madje as në ndonjë diskutim të rëndësishëm për sa i përket çështjeve në vend, apo edhe në shfrytëzimin e kapitalit njerëzor. E njëjta gjë ndodh edhe në Shqipëri dhe vendet tjera në rajon. Ekziston një përshtypje që diaspora ka rritur mosbesimin ndaj institucioneve qeveritare dhe është mjaft skeptike ndaj aftësive të tyre. Në mënyrë që të kthehet besimi, këto institucione duhet të shprehin një vullnet dhe gatishmëri më të madhe për bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare në rajon, me komunitetet e diasporës dhe bizneset nga jashtë.

Qëllimi i konferencës “Diaspora flet”

Promovimi i dialogut të strukturuar në mes të institucioneve qeveritare dhe diasporës.

Lidhja

Hapësirë ku pjesëtarët e diasporës dhe grupet e interesit mund të lidhen me institucionet publike dhe hisedarët e tjerë.

Avokimi

Hapësirë ku pjesëtarët e diasporës mund të avokojnë për të drejtat e tyre ekonomike, shoqërore dhe politike.

Angazhimi

Mundësi angazhimi për pjesëtarët e diasporës dhe grupet e interesit.

Bashkëpunimi

Hapësirë për pjesëtarët e diasporës dhe grupet e interesit për të krijuar mekanizma bashkëpunues për përfshirje në proceset politikëbërëse.



Çfarë do të arrijë konferenca?



Prezantimi i të gjeturave nga nisma Dialogu i strukturuar për të drejtat e diasporës, i zbatuar gjatë dy viteve të fundit duke përfshirë 217 grupe formale dhe joformale, 11 grupe fokusi, 7 pyetësorë dhe 4 analiza të shkurtra të politikave.



Fillimi dhe avancimi i dialogut mes pjesëmarrësve të diasporës, politikëbërësve, zyrtarëve të qeverisë qendrore dhe lokale, bizneseve private, shoqërisë civile dhe bashkësisë ndërkombëtare.



Shënimi i Ditës së hapur për Diasporën në Kuvend, si një mekanizëm për të siguruar një përfaqësim më të mirë dhe ndikim të diasporës në politikëbërje, si dhe rihforcim i angazhimit të vendit drejt avancimit të të drejtave të diasporës.



Shpallja e Planeve të veprimit nga Germin të zhvilluara nga task forca e diasporës - të përbëra nga 130 profesionistë që jetojnë në 24 shtete, për të krijuar një plan të aktiviteteve të ardhshme.

Rendi i ditës

Lidhja dhe angazhimi i diasporës me atdheun

Ceremonia e hapjes

1

0

Regjistrimi dhe Gala mbrëmja

1

Ceremonia e hapjes

Dita e Kuvendit

2

0

Dita e diasporës në Kuvendin e Kosovës

2

Konferencë punuese për të avokuar për të drejtat shoqërore dhe politike të diasporës me deputetë.

Spektori privat dhe transferi i dijës e shkathtësive

3

0

Spektori privat dhe transferi i dijës e shkathtësive

3

Prezantimi i bizneseve dhe ndërmarrjeve për t'u lidhur me kërkesat dhe mundësitë në Kosovë.

Dita e Komunave

4

0

Dita e Komunave

4

Lidhja e pjesëtarëve të diasporës me zhvillimin dhe mundësitë që ofrojnë ato.

Temat e Konferencës

Konferenca do të ofrojë hapësirën për të trajtuar problemet në lidhje me diasporën brenda këtyre 8 temave



Partnerët

Partnerët tanë përfshijnë institucionet publike, organizatat jo-qeveritare, asociacionet dhe organizatat donatore që kanë për qëllim përmirësimin e dialogut, angazhimin dhe lidhjen e diasporës në botë. Partneritetet do të fuqizojnë këto programe që janë të lidhura ose janë të ndikuara nga diaspora.

Partnerët mund të bëjnë:



Ndarje të shpenzimeve

C

Ndarja e shpenzimeve ose programi i sponsorimit ose temave individuale (p.sh. punëtori, seminare, ligjërata, ekskurzione, pritje, darka etj.)



Ndihmë teknike

T

Mbështetja e Germin-it me ndihmë teknike, logjistikë, vullnetarë dhe shërbime



Ngjarje paralele

E

Organizimi i ngjarjeve paralele duke pasur cak pjesëmarrësit e Konferencës si (p.sh. panairët e produkteve vendore, grupet e fokusit, seancat e aftësimin, prezantimet, intervistat etj.)

Sponsorët

Germin është në kërkim të mbështetjes nga ndërmarrjet private në Kosovë, Shqipëri, rajon dhe diasporë, të cilët dëshirojnë të promovojnë produktet ose brendet apo që kanë synim të mbështesin nismat qytetare si pjesë e përgjegjësisë shoqërore të kompanisë. Sponsorët janë të ndarë në tri nivele: i argjendtë (EUR 1000 - 4,999), i artë (EUR 5,000 - 9,999), dhe Platinum (10,000 +). Sponsorët mund të sponsorojnë konferencën në mënyrë të drejtpërdrejtë financiare ose përmes të mirave materiale dhe shërbimeve (p.sh. pije, vende për takime, dhoma hoteli, udhëtime, printime etj.) Germin-i do t'u qaset bizneseve të mëdha që përfaqësojnë industri të ndryshme, përfshirë këtu edhe kompanitë e fluturimeve, ndërmarrjet teknologjike, të shërbimit dhe prodhimit.



I argjendtë

€ 1,000 – €4,999



I artë

€ 5,000 – €9,999



Platinum

€ 10,000 - € 15,000

Për ne

Mbështetja e zhvillimit të vendlindjes përmes kanaleve teknologjike për shfrytëzimin e aftësive, njohurive dhe rrjetit të diasporës.



Germin është organizatë joqeveritare që përdorë teknologjinë dhe kanalet digjitale për të lidhur dhe angazhuar diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të saj amë. Ne përqipemi të eksplorojmë dhe përdorim edhe kanalet e TIK-ut për të lehtësuar më mirë dhe fuqizuar lidhjet mes diasporës, qytetarëve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor. Germin drejtohet nga një grup i profesionistëve të diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informimit dhe teknologjisë, juridikut dhe edukimit, sigurisë dhe mbrojtjes. Germin ka një rrjet prej 130 profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve me kohë të pjesshme, që aktualisht jetojnë në 24 shtete përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore. Germin poashtu ka rrjetin e 220 organizatave bashkëpunuese në Diasporë, që përfshijnë Evropën, Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Azinë dhe Australinë.

Konferenca Diaspora Flet është pjesë e programit Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës (www.diasporaflet.org), i mbështetur nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA), dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Kontakti



Adresa

Tringë Smajli, p.n., Prishtinë, Kosovë



E-mail i Germin

info@germin.org
conference@germin.org



Numri i telefonit

+ 386 49 55 31 61